



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 3461/5 Prot.

Tiranë, më 07/11/2012

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin "*Bashkia Lushnje*".

REKOMANDIM
Nr 26, datë 07/11/2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "*Bashkia Lushnje*".

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrit nr. 176 datë 02/10/2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "*Bashkia Lushnje*" me adresë lagja "*Kongresi*" Lushnjë me objekt:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale gjatë ushtrimit të detyrave dhe përmbushjes së tyre, si dhe verifikimi i përputhshmërisë së tij me ligjin nr 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, në lidhje me:**
 - Informacionin e përgjithshëm në lidhje me fushat e Tatim Taksave, Shëndetësi/Asistence, Menaxhimi dhe Survejimi, fusha të cilat do të trajtohen nga ky kontroll administrativ.
 - Qëllimin, Proporcionalitetin dhe Përshtatshmërinë;
 - Informimin e subjekteve të të dhënave;
 - Cilësinë e të dhënave personale;
 - Të dhënat sensitive;
 - Veprimtaritë e përpunuesve në lidhje me procesin, nëpërmjet kontraktimit e delegimit të të dhënave;
 - Përhapjen e të dhënave personale;
 - Transferimet ndërkombëtare të të dhënave personale;
 - Ruajtja e konfidencialitetit dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi "*Bashkia Lushnje*" mbledh, përpunon dhe ruan dosje me dokumente të cilat mbartin të dhëna personale të subjekteve të kategorisë "*tatim pagues*" në zyrat ku janë vendosur inspektorët e tatimeve.
 - Këto dosje mbahen në dollapë të cilat janë të pa siguruara me kyç.
 - Aksesit në këto dokumente nuk është i kontrolluar pasi kushdo që punon apo hyn në këtë sallë ka mundësinë të ndërhyjë në këto dosje.
 - Në këto ambiente realizohen edhe takimet me qytetarë lidhur me tatim - taksat.
 - Nuk ka një ambient të veçantë për të pritur qytetarët që kanë probleme të ndryshme me tatim- taksat.
 - Raftet janë të pamjaftueshëm për të mbajtur numrin e madh të dosjeve.
 - Shumë dosje janë të vendosura edhe jashtë rafteve.
 - Distanca midis tavolinave të punës të inspektoreve të tatimeve është shumë e vogël.
 - Ka një numër të madh punonjësish në këtë zyrë.
 - Ambienti është shumë i lartë dhe shumë i gjatë, ka vetëm një derë, ka dritare të pasigurta.
 - Në rast zjarri dokumentet janë të pambrojtura.

2. Kontrolluesi "*Bashkia Lushnje*" mbledh, përpunon dhe ruan dosje me dokumente të cilat mbartin të dhëna personale të subjekteve të të dhënave personale të kategorisë "*qytetarët në nevojë*" në ambientet e drejtorisë të shërbimit social dhe në zyrat rajonale të shërbimit social ku janë vendosur edhe punonjësit e shërbimeve sociale.
 - Këto dosje mbahen në dollapë të cilat janë të pa siguruara me kyç.
 - Aksesit në këto dokumente nuk është i kontrolluar pasi kushdo që punon në këto zyra ka mundësinë të ndërhyjë në dosjet e punonjësve të tjerë.
 - Në këto ambiente realizohen dhe takimet me qytetarët që kanë nevojë për asistencë nga kontrolluesi.
 - Nuk ka një ambient të veçantë për të pritur qytetarët me probleme sociale dhe shoqërore.
 - Raftet janë të pamjaftueshëm për të mbajtur numrin e madh të dosjeve.
 - Tavolinat e punës të punonjësve të kësaj drejtorie si edhe në zyrat rajonale janë shumë afër njëra tjetrës.

3. Kontrolluesi "*Bashkia Lushnje*" nuk ka zhvilluar një sistem elektronik të përpunimit të informacionit, për shkak të pamundësisë për të lidhur në një rrjet të vetëm kompjuterik pajisjet informatike të zyrave si pasojë e amortizimit të ambienteve të godinës. Kontrolluesi nuk disponon pajisje kompjuterike server dhe as program qendror menaxhimi të dokumenteve. Në Drejtorinë e kontrolluara përdoret një numër i kufizuar kompjuterësh për punonjësit, të cilët nuk janë të lidhur në Internet. Janë në funksion elementet bazë të sigurisë si aksesit me fjalëkalim dhe programe antivirus.

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se është e nevojshme të hartohet një manual rregullash mbi përdorimin dhe aksesin e pajisjeve kompjuterike nga personeli, si dhe sigurinë e të dhënave gjatë përpunimit automatik. Kjo do të shërbente dhe në kuadër të zhvillimit të një sistemi elektronik menaxhimi dokumentesh në të ardhmen.

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se është e rëndësishme që të dhënat personale të mbahen të sigurt dhe që të mos keqpërdoren apo korrumpohen në ndonjë mënyrë. Siguria së pari ka të bëjë me marrjen e masave fizike, me organizimin e punës në një mënyrë të tillë që risku të minimizohet, duke siguruar që personeli të mund t'i shoh të

dhënat vetëm kur kjo është e nevojshme që ata të kryejnë punën e tyre në mënyrën e duhur, si dhe duke vendosur rregulla për punonjësit në lidhje me çfarë duhet dhe nuk duhet të bëjë. Niveli i sigurisë duhet të jetë në nivelin e riskut të paraqitur nga përpunimi dhe natyra e të dhënave. Sa më i madh është rreziku që mund të shkaktohet nëse gjërat shkojnë keq, aq më të rrepta duhet të jenë masat e sigurisë. Aksesit në ambientet e punës të lejohet vetëm për punonjësit e zyrës, hyrja e personave të tjerë që nuk janë të autorizuar të kenë akses në këto ambiente duhet të ndalohej.

Duhet të sigurohet që përpunimi i të dhënave personale të bëhet vetëm sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe të ndalohej përdorimi i dosjeve nga persona të paautorizuar. Të sigurohet që ndryshimi, korigjimi, fshirja dhe transferimi dhe veprime të tjera në lidhje me të dhënat personale, të regjistrohen dhe të dokumentohen. Të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm dhe të garantohet që stafi të jetë i ndërgjegjësuar dhe i trajnuar rreth nevojës së sigurisë të të dhënave personale dhe përforcimit të saj. Niveli i sigurisë të konsiderojë natyrën e të dhënave personale të cilat përpunohen dhe të realizohet duke vlerësuar natyrën e këtyre të dhënave personale. Duhet të përcaktohen rregulla dhe një politikë e qartë për konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale që përpunohen gjatë aktiviteti tuaj.

4. Kontrolluesi "*Bashkia Lushnje*" ka në fuqi "*rregulloren e brendshme*" të tij ku ka të parashikuar rregulla të veçanta lidhur me trajtimin, mbledhjen dhe përpunimin e dokumentacionit nga punonjësit e drejtorisë të tatim-taksave dhe drejtorinë e shërbimeve sociale, gjithashtu ka parashikuar dhe disa rregulla lidhur me konfidencialitetin.

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se këto rregulla janë të pamjaftueshme, pasi në këto drejtori të dhënat personale që mbledhen dhe përpunohen janë të shumta, janë të dhëna sensitive lidhur me shëndetin dhe gjendjen gjyqësore.

Hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj edhe në "*rregulloren e brendshme*" që është në fuqi duhet të ketë pjesë të cilat lidhen me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues. Duhet të trajtohen në mënyrë specifike çështjet e privatësisë, të hartohen procedura të reja ose të përfshihen në ato ekzistuese, detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se mungesa e marrjes së këtyre masave bie në kundërshtim me nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" ... "*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*".

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, **brenda një periudhe 2 (dy) mujore** të merren masa për mbrojtjen, aksesin dhe sigurinë fizike të dosjeve me dokumente të cilat mbartin të dhëna personale në zyrat e tatim-taksave dhe shërbimeve sociale.
2. Në zbatim nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, **brenda një periudhe prej 45 (dyzetë e pesë) ditësh** të hartohen rregulla lidhur me:
 - Mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurisë e të dhënave personale.
 - Konfidencialitetin e të dhënave personale
 - Përdorimin dhe aksesin e pajisjeve kompjuterike nga personeli, si dhe sigurinë e të dhënave gjatë përpunimit automatik.
3. Për plotësimin e këtij detyrimi te njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Me kalimin e këtyre afateve në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

